



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 3 dhjetor 2015
Nr. ref.: RK866/15

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI99/15

Parashtrues

Axhi Thaçi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit (SCEL- 09-0009) të Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të 12 nëntorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Axhi Thaçi nga Prizreni (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin (SCEL- 09-0009 të 12 nëntorit 2013) e Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Specializuar i DHPGJS), të cilin parashtruesi i kërkesës e kishte pranuar më 13 nëntor 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të lartcekur të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS. Parashtruesi i kërkesës konsideron se Aktgjykimi është nxjerrë *“duke mos respektuar barazinë e palëve – punëtorëve gjatë përpilimit të listës për realizimin e 20%”* me çka është shkelur neni 24 [Barazia para Ligjit] i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 23 korrik 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 19 gusht 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin GJR. KI99/15, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja, me Vendimin KSH. KI99/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 14 shtator 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin dhe Kolegjin e Specializuar të DHPGJS për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 14 tetor 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 31 gusht 2006, NSH “Hotel Theranda” nga Prizreni ishte privatizuar.
10. Lista përfundimtare e punëtorëve të cilët i kishin plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të 20% të të hyrave nga procesi i privatizimit të NSH “Hotel Theranda” nga Prizreni është publikuar në gazetën ditore më 21, 22, 23 dhe 24 maj 2009.
11. Sipas nenit 67.6 të Udhëzimit Administrativ 2008/06 në lidhje me nenin 10.6 (a) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13, ankesa kundër listës

përfundimtare duhet të dorëzohet brenda 20 (njëzet) ditëve pas publikimit të listës përfundimtare.

12. Afati i fundit për paraqitjen e ankesave në Kolegjin e Specializuar të DHPGJS, kundër listës përfundimtare të punëtorëve të NSH "Hotel Theranda" ishte 13 qershori 2009.
13. Më 22 qershor 2009, parashtruesi i kërkesës (ankuesi C-0022) parashtroi ankesë në Kolegjin e Specializuar të DHPGJS me të cilën kërkoi që të përfshihej në listën përfundimtare të punëtorëve të NSH "Hotel Theranda".
14. Më 12 nëntor 2013, Kolegji i Specializuar i DHPGJS me Aktgjykimin (SCEL-09-0009) e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës (ankuesi C-0022) si "... të pa pranueshme, pasi ishte dorëzuar jashtë afatit..." me këshillën juridike si në vijim:

"Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë brenda 21 ditësh tek Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme. [...] Afati i paraparë fillon në mesnatën e asaj dite kur ankuesit i është dërguar aktgjykimi me shkrim".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Kolegji i Specializuar i DHPGJS kishte nxjerrë Aktgjykimin e kontestuar *"duke mos respektuar barazinë e palëve – punëtorëve gjatë përpilimit të listës për realizimin e 20%"* me çka është shkelur neni 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës si në vijim:

"... më është mohuar e drejta në realizimin e 20% si punëtor i NSH "Hotel Theranda" nga Prizreni pas privatizimit ... pa bazë fare, dhe në listën e ankesave si në faqen e I të aktgjyimit në fjalë janë përfshi dhe kanë realizuar persona të cilët fare nuk kanë qenë aktiv në këtë ndërmarrje ... ndërsa mua edhe pse kam qenë aktiv dhe i kyçur në këtë çështje më kanë hequr nga lista e 20%..."

16. Parashtruesi i kërkesës pretendon se *"... kam qenë i sëmurë dhe jam kuruar me një diagnozë psikiatrike dhe atë prej dt. 08. 04.2009 deri më dt. 15.09.2009, kur dhe ka qenë afati për të ushtruar ankesë, të cilën për shkaqe shëndetësore nuk kam mundur që të veprojë [...] dhe nuk është e vërtetë se e kam pranuar aktgjykimin – në fletëdërgesë nuk është nënshkrimi im"*.
17. Parashtruesi kërkon nga Gjykata që të *"më mundëson ... futjen në listën e realizimit të të drejtës në pjesën prej 20% që më takon pas privatizimit të ndërmarrjes - NSH „Hotel Theranda"*.

Pranueshmëria e kërkesës

18. Gjykata do të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmeri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
19. Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

20. Për më tepër, Gjykata i referohet edhe nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor”.

21. Gjykata, më tej, i referohet rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

(c) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesit”.

22. Gjykata vëren se Aktgjykimi (SCEL- 09-0009 të 12 nëntorit 2013) i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS i është dorëzuar parashtruesit më 13 nëntor 2013; parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatë më 23 korrik 2015; kërkesa u dorëzua në Gjykatë pas skadimit të afatit prej 4 (katër) muajve nga data kur i është dorëzuar Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar DHPGJS.
23. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson se afati prej 4 (katër) muajsh sipas nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës është i natyrës prekluzive dhe është themeluar për të siguruar parimin e sigurisë juridike, duke siguruar që kërkesat të cilat dorëzohen në pajtim me Kushtetutën shqyrtohen brenda një kohe të arsyeshme, dhe se vendimet nga e kaluara nuk mund të jenë vazhdimisht të hapura për vlerësim kushtetues (Shih rastin: *O’Loughlin dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 23274/04, GJEDNJ, vendimi i 25 gushtit 2005).
24. Nga kjo rrjedh se kërkesa është dorëzuar jashtë afatit të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, dhe si e tillë është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113, paragrafi 7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 14 tetor 2015, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 paragrafi 4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Altay Suroy



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi